



Република Северна Македонија Republika e Maqedonisë së Veriut
Општина Липково Komuna e Likovës
Tel/Fax: +389/31-463-180; 031/463-179
e-mail: m_likova@yahoo.com
Web: www.komunaelikoves.gov.mk

Бр./Nr. 18-272/5 од/дт. 10.03.2020

Në bazë të nenit 35, paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik („Gz. zyrtare e RM-së,, nr.199/14, 44/15), nenit 50, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gz. zyrtare e RM-së,, nr.5199/2014, 44/2015, 157/2015, 193/2015, 31/2016, 90/2017, 64/2018, 168/2018), nenit 22 të Statutit të Komunës së Likovës dhe miratimit të Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2020 me Vendim nr. 08-1307/19 dt 30.12.2019 nga Këshilli i Komunës së Likovës, Kryetari i Komunës së Likovës e jep këtë:

L A J M Ě R I M

Për organizimin e prezentimit publik dhe anketës publike për Propozimine Kryetarit të Komunës së Likovës

Kufijtë e përfshirjes planore janë: **Planit urbanistik jashtë vendbanimit – PUJV për ndërtimin e G2 – industri e lehtë jondotëse, A4-vendosje e përkohshme dhe B2-Njësi të mëdha tregtare në v.q. Shamak, KK Opajë, Komuna e Likovës.**

Përfshirja është sipërfaqe prej 2,3 ha.

Anketa publike dhe prezentimi publik me propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Anketa Publike do të zgjatë 5 ditë pune edhe ate prej 18-24.03.2020, çdo ditë pune nga ora 10,00 deri 15,00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesur dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërtetje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezentimi publik me prezentimin profesional të planit do të mbahet më dt.20.03.2020 në ora 10,30 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoi, Ida Dije Arifi
Kontrolloi, Xhezmi Musliji
Aprovoi, Nexhadi Osmani

Komuna e Likovës
Kryetar,
m. Erkan Arifi

